



Takim i përbashkët i grupit të punës së IOPS-it dhe OECD-së mbi pensionet private

Vijon në faqen 2

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-maj 2013

Vijon në faqen 2

ZHVILLIME TË TJERA

Takim i autoriteteve mbikëqyrëse mbi Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IFRS) (3-7 qershor 2013)

Vijon në faqen 3

Zhvillohet mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s (12 qershor 2013)

Vijon në faqen 5

Thelohet bashkëpunimi i AMF-së me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Estonisë

(17-18 qershor 2013)

Vijon në faqen 6

Tregjet financiare dhe instrumentet e rinj financiarë (10-21 qershor 2013)

Vijon në faqen 7

LAJMET NGA RAJONI

Çeki *Vijon në faqen 8*

Greqi *Vijon në faqen 8*

Kroaci *Vijon në faqen 8*

Qipro *Vijon në faqen 9*

Rumani *Vijon në faqen 9*

Turqi *Vijon në faqen 10*

Takim i përbashkët i grupit të punës së IOPS-it dhe OECD-së mbi pensionet private

(3-4 qershor 2013)

Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mori pjesë në takimin e përbashkët të grupit të punës së IOPS-it, Organizatës Ndërkombëtare të Rregullatorëve të Pensioneve (*International Organisation of Pensions Supervisor*) dhe OECD-së, Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (*Organisation for Economic Cooperation and Development*) mbi pensionet private. Takimi synonte shkëmbimin e përvojave më të mira për zhvillimin e reformave në sistemin e pensioneve, përmirësimin e kuadrit ligjor, si dhe ndërtimin e strukturave efikase dhe kapaciteteve teknike si një kusht për krijimin e sistemeve të shëndetshme të pensioneve private.

Në këtë mbledhje, ndër të tjera, u diskutua për çështjet që lidhen me:

- rishikimin e principeve bazë të rregullimit dhe mbikëqyrjes së pensioneve private;
- principet mbi investimet afatgjata nga investitorët institucionalë;
- vdekshmëria dhe risku i jetëgjatësisë;
- tregjet e kapitalit dhe instrumentet për transferimin e riskut të jetëgjatësisë, etj.

Në vazhdim u zhvilluan edhe mbledhjet e Komiteteve Ekzekutive (EC) dhe Teknike (TC) të IOPS-it. Komiteti Ekzekutiv diskutoi mbi zhvillimet më të fundit dhe çështjet administrative të organizatës. Ndërsa në mbledhjen e Komitetit Teknik u paraqit draft-udhëzuesi i përgatitur nga grupet e punës mbi praktikën më të mira për qeverisjen e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve, si dhe mbi kërkimet e informacionet e mbledhura nga organizma të tjerë ndërkombëtare si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar që bashkëpunojnë me IOPS-in në fushën e pensioneve.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar - maj 2013

Tregu i sigurimeve u rrit me 1.64% në janar-maj 2013. Volumi i primeve të shkruara bruto në pesë muajt e parë të vitit arriti në 3.39 miliardë lekë, ndërsa numri i policave të sigurimit pati një rritje me 0.10% dhe arriti vlerën e 381,926 policave.

Sigurimi Jo-Jetës u ul me 0.58% në janar-maj 2013 krahasuar me të njëjtën periudhë e një viti më parë. Ndërsa sigurimi i Jetës u rrit me

Në mbledhjen e Komitetit Teknik u paraqit draft-udhëzuesi i përgatitur nga grupet e punës mbi praktikën më të mira për qeverisjen e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve

15.70% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërkohë, dëmet e paguara bruto regjistruan një ulje me 10.96% në krahasim me janar-maj 2012.


Sigurimi i detyrueshëm motorik

Sigurimi i detyrueshëm për periudhën janar-maj 2013 përbën 42.65% të tregu të sigurimeve të Jo-Jetës. Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën 1.44 miliardë lekë, me një ulje prej 5.02% nga janar-maj 2012.

Jo-Jeta, të tjera

Klasa të tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës përbëhen nga *zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë* të cilat zunë 22.64% të tregut të Jo-Jetës, si dhe klasat *sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme* të cilat së bashku zunë 16.01% të tregut të Jo-Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-maj 2013



ZHVILLIME TË TJERA

Takim i autoriteteve mbikëqyrëse mbi Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IFRS)

Qendra e Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR) dhe themeluesit e IFRS-ve (IFRS Foundation) zhvilluan në datat 3-7 qershor 2013, në Vjenë, Austri, takimin mbi Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IFRS). Në takim morën pjesë përfaqësues të agjencive rregullatore



Sigurimi i Jetës për periudhën janar-maj 2013 u rrit me 15.70% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Mbikëqyrësit e tregut bankar dhe tregut të sigurimeve duhet të zhvillojnë kapacitetet e tyre për të përdorur informacionin financiar bazuar në SNRF për monitorim dhe mbikëqyrje efektive.

përgjegjëse për mbikëqyrjen e bankave, kompanive të sigurimit dhe tregut të letrave me vlerë në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Qëllimi i takimit ishte zgjerimi i njohurive të pjesëmarrësve për SNRF-në aktuale, ndryshimet e pritshme në të ardhmen, si dhe kërkesat për një mbikëqyrje efektive.

Në takim u theksua:

- Zbatimi i SNRF-së aktuale për instrumentet financiarë dhe kontratat e sigurimit;
- Përcaktimi dhe matja me vlerë të drejtë e aktiveve dhe pasiveve financiare në përputhje me IFRS 13 (Efektiv prej muajit janar 2013);
- Qëllimi për një model të vetëm konsolidimi bazuar në “kontroll” sipas IFRS 10;
- Përditësimi mbi ndryshimet e sugjeruara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) përmendim këtu projektin për të zëvendësuar SNK 39 “Njohja dhe Matja e instrumenteve Financiare” me SNRF 9 “Instrumentat Financiarë” dhe projektin e saj për të zëvendësuar SNRF 4 “Kontratat e sigurimit” me një standard të plotë për kontabilizimin dhe raportimin e kontratave të sigurimit. Gjatë takimit u diskutua mbi zbatimin e SNRF-së nga Komisioni Evropian dhe aspekte të tjera që lidhen me zbatimin e SNRF-së nga rregullatorët kombëtarë dhe institucionet financiare.

Takimi u fokusua në masat e ndërmarra nga “Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare” (publikuar në dhjetor të vitit 2010) për të përmirësuar mbikëqyrjen efektive të bankave, zakonisht të referuara si “Bazel III”. Këto masa do të iniciohen nga viti 2013 dhe do të bëhen plotësisht të detyrueshme në vitin 2019.

Paralelisht u theksua rëndësia e Direktivës “Solvency II” (miratuar në nëntor 2009) dhe lidhjet e kësaj direktive me IFRS. Gjithashtu u trajtuan përkufizimet e kontratës së sigurimit, tiparet e kontratave të sigurimit me pjesëmarrje (*eng. discretionary participation feature*), produktet e sigurimit të Jetës, vlerësimi/kontabilizimi i bonuseve të garantuara, vlerësimi i policave të sigurimit me fitim, pasqyrimi i drejtë i rezultatit teknik të sigurimeve dhe vlerësimi me “*fair value*” i provigjoneve teknike duke marrë në konsideratë vlerën në kohë të parasë, shkallën e pasigurisë dhe ndryshimin e shkallës së rrezikut.

Të gjitha bankat dhe kompanitë e sigurimeve në Bashkimin Evropian përveç kërkesave të raportimit financiar do të duhet të përmbushin këto dy direktiva. Kështu, mbikëqyrësit e tregut bankar dhe tregut të sigurimeve duhet të zhvillojnë kapacitetet e tyre për të përdorur informacionin financiar bazuar në SNRF për monitorim dhe mbikëqyrje efektive.

Zhvillohet mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s

Nënkryetarja e AMF-së, Znj. Enkela Idrizi mori pjesë në mbledhjen e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s, Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Letrave me Vlerë (*International Organization of Securities Commissions*) e cila u zhvillua në 12 qershor në Madrid, Spanjë. Në strukturën e IOSCO-s funksionojnë edhe katër komitete të specializuara sipas rajoneve që mbledhen rregullisht për të diskutuar për problemet rajonale. Komiteti Evropian është njëri nga këto komitete, anëtare e të cilit është edhe AMF.



Në këtë mbledhje u diskutua për:

- Zhvillimet financiare rregullatore dhe tendencat e tregjeve financiare në Evropë;
- Problemet kryesore në procesin e reformës rregullatore globale;
- Praktikrat në industri dhe kodet e sjelljes joformale;
- Risqet e manipulimit të tregut dhe sanksionet;
- Identifikimin dhe trajtimin e risqeve të mundshme sistemike në rajon.

Gjatë mbledhjes u shkëmbyen ide lidhur me mundësitë e drejtimeve të reja të bashkëpunimit, si për çështjet e bashkëpunimit ndërkufitar dhe qeverisjen korporative.

Një vëmendje e veçantë ju kushtua edhe çështjeve që lidhen me kërkimin dhe zhvillimin e praktikave të reja për:


- Derivatet OTC (*Derivatives: Over-the-counter, OTC*) pra për shkëmbimet që bëhen drejtpërsëdrejti midis dy palëve pa ndërhyrjen e një pike shkëmbimi;
- Hartimin dhe prezantimin në bord të disa standardeve financiare (*Financial Markets' Benchmarks—final Principles*)
- Kërkimin nga IOSCO: Propozimet lidhur me një udhëzues për identifikimin, monitorimin dhe minimizimin e risqeve sistemike.

Në mbledhje u diskutuan edhe çështjet organizative lidhur me procesin e nënshkrimit të marrëveshjeve multilaterale të bashkëpunimit prej disa organizmave anëtare të IOSCO-s.

U shkëmbyen ide lidhur me mundësitë e drejtimeve të reja të bashkëpunimit, si për çështjet e bashkëpunimit ndërkufitar dhe qeverisjen korporative.

Thellohet bashkëpunimi i AMF-së me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Estonisë

Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, së bashku me një grup drejtuesish të AMF-së zhvilluan në datat 17-18 qershor 2013 takime pune pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Estoni. Takimet u përqendruan në diskutime mbi përvojat e përbashkëta, veçoritë specifike dhe eksperiencat që të dy rregullatorët kanë në tregjet respektive.



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Estonisë (*Finantsjärelvalve Eesmärk*) është krijuar në janar 2002, si bashkim i funksioneve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Bankare, *Eesti Pank* (BSA), Autoritetit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS) dhe Inspektoratit të Letrave me Vlerë. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Estonisë është institucion i pavarur dhe kryen mbikëqyrjen e sistemit bankar, tregjeve të letrave me vlerë dhe sigurimeve.

Takimi dyditor i mbajtur në Estoni ishte vijim i zhvillimit të marrëdhënieve dypalëshe në interes reciprok për të dy autoritetet mbikëqyrëse.

Mbikëqyrja shtetërore mbi bankat, sigurimet dhe tregun e letrave me vlerë nëpërmjet një autoriteti të vetëm kompetent u konsiderua e nevojshme, së pari, nga nevoja për integrimin e tregjeve financiare e shërbimeve dhe së dyti, për lehtësimin e vlerësimit më efikas të riskut dhe menaxhimin e krizave. Ky bashkim siguron dhe një cilësi më uniforme të mbikëqyrjes financiare mbi tregun financiar në tërësi.

Gjatë takimeve, ndër aspektet më me interes të diskutimeve dhe shkëmbimit të përvojave ishin:

- Forcimi i pavarësisë së autoritetit rregullator;
- Rritja e efektshmërisë në zbatim të vendimeve të autoritetit mbikëqyrës;
- Mbikëqyrja e tregut të fondeve të pensioneve vullnetare private;
- Marrëdhëniet e autoritetit mbikëqyrës me gjykatat dhe grupet e tjera të interesit, me synim zbatueshmërinë më të lartë të vendimeve të autoritetit mbikëqyrës;
- Hartimi dhe përmirësimi i programeve të edukimit financiar të konsumatorëve dhe investitorëve në funksion të përmirësimit të mbrojtjes konsumatore.

Takimi dyditor i mbajtur në Estoni ishte vijim i zhvillimit të marrëdhënieve dypalëshe në interes reciprok për të dy autoritetet mbikëqyrëse. Kjo u shpreh edhe nga dy drejtuesit e autoriteteve, të cilët deklaruan interesin për të forcuar më tej marrëdhëniet institucionale.

Tregjet financiare dhe instrumentet e rinj financiarë

Instituti për Zhvillimin e Kapaciteteve pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar në bashkëpunim me Institutin “*Joint Vienna Institute*” zhvilluan trajnimin mbi tregjet financiare dhe instrumentet e rinj financiarë në Vjenë, Austri gjatë periudhës 10-21 qershor.

Tematikat kryesore të trajnimit përfshinin natyrën e ndërmjetësimit financiar, rolin i tregjeve dhe institucioneve financiare në alokimin e burimeve dhe nevoja për mekanizma rregullatorë për të krijuar stimuj të përshtatshëm për gjithë pjesëmarrësit në sistemin financiar. Kursi i kushtoi vëmendje të veçantë lindjes së tregjeve dhe instrumenteve derivateve. Gjithashtu u analizuan bazat teorike të instrumenteve të reja, duke përfshirë mënyrat e përcaktimit të çmimeve të tyre dhe strategjitë për tregtim, si dhe mënyrën se si organizmat financiare mund t’i përdorin ato për menaxhimin e riskut.

Temat specifike përfshinin çështje si:

- Struktura e tregut financiar dhe rregullimet;
- Tregjet e kapitalit (afatshkurtër dhe afatgjatë);
- Derivatet dhe përcaktimi i çmimit të tyre;
- Menaxhimi i riskut në bankat tregtare;
- Modelet e riskut të kredisë, etj.

Trajnimi përfshinte një kombinim në raporte proporcionale të shpjegimeve teorike me rastet studimore dhe eksperiencën nga tregjet financiare kudo në botë. Gjatë diskutimeve për krizën financiare në Evropë dhe SHBA u trajtua rastet studimore nga bankat e Qipros, Spanjës, Irlandës, si dhe ndërhyrjet nga Banka Qendrore e Anglisë apo edhe Rezervës Federale në SHBA.

Pjesëmarrësit në trajnim sollën eksperiencat e tyre në diskutime dhe në grupet e punës për prezantimin e çështjeve që lidheshin me zhvillimet e tregjeve financiare lokale.

Instituti *Joint Vienna Institute* është një qendër ndërkombëtare trajnimi që ofron kurse për zyrtarë dhe menaxherë nga vendet e Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore, Komonuelthi i Shteteve të Pavarura, dhe Azia. Instituti është ngritur në vitin 1992 nga pesë organizata ndërkombëtare dhe me mbështetjen e autoriteteve austriake për t’iu përgjigjur kërkesës nga ekonomitë në tranzicion për të trajnuar mbi ekonominë e tregut dhe sistemin e lirë të ndërmarrjeve.



Joint Vienna Institute

IMF Course on Financial Markets and New Financial Instruments
June 10 - 21, 2013



Gjatë diskutimeve për krizën financiare në Evropë dhe SHBA u trajtua rastet studimore nga bankat e Qipros, Spanjës, Irlandës, si dhe ndërhyrjet nga Banka Qendrore e Anglisë apo edhe Rezervës Federale në SHBA.

LAJMET NGA RAJONI

Çeki

www.xprimm.com

Sipas siguruesve të vendit, dëmi i shkaktuar nga përmbytjet në Republikën Çeke mund të kushtojë 293 milion euro. Shoqata e Sigurimeve Çeke, anëtarët e të cilët mbulojnë 98% të tregut, ka regjistruar së fundmi 10,000 kërkesa për dëme, por më vonë u deklarua se numri i tyre mund të rritet. Qeveria Çeke ka dhënë një fond prej deri 5.3 miliardë CZK (monedha lokale ose përafërsisht 204 milionë euro) për riparimin e përmbytjeve.



Përmbytjet e këtij viti nuk kanë qenë aq serioze sa ato që goditën qendrën historike të Pragës në vitin 2002, të cilat ju kushtuan sigurimeve çeke 35 miliardë CZK (monedha lokale ose përafërsisht 1.35 miliard euro).

Tregu i sigurimit të Jetës, në Kroaci është rritur me 7.8% duke përfaqësuar pothuajse një të katërtën e tregut.

Greqi

www.xprimm.com

Sipas raportit të tremujorit të parë 2013, botuar nga Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimit (HAIC), siguruesit grekë raportuan një vlerë të primeve të shkruara bruto prej 1.02 miliard euro në tremujorin e parë, krahasuar me 1.18 miliard euro për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në periudhën e analizuar, primet e sigurimit të Jo-Jetës shënuan 60% të totalit të primeve të sigurimit me 611 milion euro, ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës, pjesën e mbetur të tregut, me 410 milion euro.



Kroaci

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Byroja e Sigurimeve Kroate, 27 kompanitë e sigurimit që veprojnë në Kroaci, për tremujorin e parë të vitit 2013 gjeneruan 332 miliardë euro nga primet e shkruara bruto, me një ulje prej 0.7%, duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012.



Në përgjithësi, tregu i sigurimit të Jetës është rritur me 7.8% duke përfaqësuar pothuajse një të katërtën e tregut. Lidhur me tregun e Jo-Jetës, volumi i primeve të shkruara bruto arriti në vlerën 250 miliardë

euro, me një rënie prej 3.2% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2012, duke zënë rreth 75.5% të totalit të primit në tregun e sigurimeve kroate. Klasa më e madhe e sigurimit të Jo-Jetës mbetet TPL me një total të primeve të shkruara bruto prej 693.7 milion HRK (përafërsisht 93 milion euro) dhe me një rritje prej 1.7%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të shkuar. Më pas renditen sigurimet e pronës (zjarri, rreziqe shtesë dhe dëmtime të pronës,) që zunë rreth 19% të totalit të tregut. Sigurimi Kasko arriti një total prej 185.4 milion HRK (përafërsisht 24.89 milion euro) në primet e shkruara bruto, duke pasur një ulje prej 7.3% krahasuar me tremujorin e parë të 2012.

Qipro

www.xprimm.com

Sipas raportit të Shoqatës së Sigurimeve të Qipros, në fund të marsit 2013, tregu i sigurimeve të Qipros arriti vlerën 211.8 milion euro ose 6.7% më pak se tremujori i parë i vitit 2012.



Në klasat kryesore të sigurimeve, rënia më e madhe në primin e shkruar bruto është regjistruar në sigurimin e Jetës, nga 100 milion euro arriti në 90 milion euro ose 10% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa sigurimi i Jo-Jetës arriti vlerën 121.8 milion euro me një ulje prej 2.7% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2012. Në tregun e sigurimit të Jetës, 8 nga 11 sigures shënuan një rënie të primit të shkruar bruto, ndërsa në sigurimin e Jo-Jetës, 18 nga 28 kompani aktive raportuan rënie.

Rumani

www.xprimm.com

Rezultati për tremujorin e parë në tregun e sigurimeve të 2013 u mbyll me një rënie të dobët të tregut krahasuar me të dhënat e të njëjtës periudhë të vitit 2012. Sipas siguresve rumunë, tregu pati një rënie prej vetëm 3% të volumit të biznesit, përafërsisht 15 milion euro më pak se tremujori i parë i vitit 2012. Kjo rënie nuk vjen nga tërësia e tregut, i cili arriti në afërsisht rreth 500 milion euro në total.

10 shoqëritë më të mëdha të sigurimeve të renditura nga tregu arritën një volum të primeve të shkruara bruto prej 400 milion euro. Nga 10 më të mirët e tregut vetëm 3 prej tyre patën rënie, pasi pjesa tjetër regjistroi një rritje. Kjo analizë tregon për një përqendrim të tregut, të rritur me 4 pikë përqindje më shumë. 10 siguresit më të mirë përfaqësojnë rreth 82% të të gjithë biznesit të sigurimeve në Rumani.



Bizneset e prekura nga protestat në Turqi kanë kërkuar nga ta marrjen e kompensimit. Shuma totale që duhet të paguhet për pronarët e prekur është aktualisht e panjohur.

Turqi

www.xprimm.com

Shoqata Turke e Sigurimeve, e cila ka aktualisht më shumë se 200 kompani të sigurimeve në përbërjen e saj, vlerësoi dëmin e shkaktuar nga protestat e zhvilluara në vend muajin e kaluar. Bizneset e prekura nga këto protesta kanë kërkuar nga ta marrjen e kompensimit.



Shuma totale që duhet të paguhet për pronarët e prekur është aktualisht e panjohur.

Protestat në Sheshin Taksim në Stamboll kanë vazhduar për më shumë se 10 ditë. Zëvendëskryeministri Bulent Arinç tha se dëmi i shkaktuar nga protestat në Turqi mund të tejkalojë 70 milionë TRY (monedha turke përafërsisht 28 milionë euro).

Për këtë numër punuan:

*R. Guri, D. Kalaja, A. Dervishi, J. Mele, R. Eltari,
Dh. Hazbiu, E. Beqir-Aga, E. Kokona*